



Datë: 08.10.2025
Numër Protokolli: 6701/2025

A.nr.1583/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1583/2025, të datës 11.08.2025, të parashtruar nga ankuesi, Z.K, kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1583/2025, të datës 11.08.2025, të parashtruar nga ankuesi, Z.K.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, Z.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 11.08.2025 përmes postës elektronike (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017330, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht, për pozitën e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë në Rajonin e Gjilanit, të shpallur nga Inspektorati i Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 25.08.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa, kjo e fundit, nuk ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1583/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës, më datë 21.03.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00017330, Për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës “Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punë” në Rajonin e Gjilanit, me klasë të pozitës Profesional 1, tre (3) vende të lira pune, i hapur për aplikim nga data 22.03.2025 deri më datën 20.04.2025.

Tutje, sipas provave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs dhe se i njejt ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i ‘u nënshtruar vlerësimit profesional, Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, ka publikuar njoftimin për rezultatet përfundimtare me (4) kandidatë të suksesshëm.

Pas publikimit të Njoftimit të rezultateve, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e kësaj procedure për shkak të shkeljeve ligjore dhe shkeljeve procedurale pretendon se përbërja e Komisionit të pranimit është e kundërligjshme dhe është formuar nga personi pa autorizim ligjor. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj procesin e rekrutimit në tërësi.

Duke qenë së kandidatja A.Sh.D, si kandidate aplikuese në procedurën e rekrutimit me Nr. Reference: RN00017330, Grupi Administrim i Përgjithshëm, pozita e punës Inspektor për Siguri dhe Shëndet në Punës në Divizionin për Inspektim në Rajonin e Gjilanit, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën e njëjtë, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A.nr.1530/2025, të datës 01.10.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00017330.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1583/2025, të datës 11.08.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1530/2025, të datës 01.10.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi këtë procedurë, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesja në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”, Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.1583/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1583/2025, të datës 11.08.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1583/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Ardita Haxhnikaj Demi

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, Z.K;
- Njesisë se Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës ; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.